



REPUBLIKA E SHQIPĒRISË  
KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV  
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 649 prot

Tiranë, më 12.11 2024

**VENDIM**

Nr. 8 datë 12.11 2024

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E  
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE  
VENDORE TË DATËS 8/11/2024**

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, të mbledhjes së datës 8.11.2024 vendosi:

1. Për projektvendimin “**Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 867, datë 10.12.2014 Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore**” propozuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Shtojca A ”Marrëveshje Bashkëpunimin (TIP) ndryshohet në nenin 6, pika2 duke shtuar pas shkronjës g), shkronjën gj) me këtë përbajtje: “në rastet kur evidentimi në terren kryhet nga specialistët e bashkisë, akti i evidentimit në terren nënshkruhet prej tyre sipas formatit të miratuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1178 datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

2. Për projektvendimin “**Mbi procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitet dhe rolet e përdoruesve të sistemit të strehimit social**” propozuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Pika 8, për individët me nevojë emergjente për strehim bashkitë kanë fonde të limituara. Duhet të rishikohet mënyra e menaxhimit dhe afati kohor për këtë shërbim;
  - Tarifat për aplikime për personat me aftësi të kufizuara do të paguhen nga bashkia duke shtuar detyrimet për bashkitë ndërkokë që bashkia ka fonde të cunguara për rrjetet e sugjerojmë të rishikohet kjo pikë;
  - Pika 11, e projektvendimit “Rolet e përdoruesve të sistemit të strehimit social “ nuk përmendet fare roli i Komisionit të Strehimit dhe kryetarit të Bashkisë.
3. Për projektudhëzimin “**Për bazën e të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar dhe vendor**”, propozuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Pika 13 “Detyrimet për Ndryshimet e Arkitekturës së Sistemit”. Projektvendimi parashikon që çdo ndryshim në arkitekturën e software-it dhe hardware-it të bazës së të dhënave të bëhet në përputhje me standartet dhe praktikat ndërkombëtare. Bashkië mund të mos kenë burime financiare dhe teknike për të përmbushur këto standarde, duke u bërë të varura nga qeveria qendrore për mirëmbajtjen e sistemit
4. Për projektligjin “**Për shitjen e pasurive të paluajtshme shtetërore poseduesëve faktikë jopronare në zonat me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore**”, propozuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Të përfshihen në ligj dhe zonat kodrinore si ullishtet apo vreshtat që kanë një potencial për zhvillimin e turizmit.
5. Për projektligjin “**Buxheti i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2025**”, propozuar nga Ministria e Financave, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Transferta sektoriale për rrugët rurale që i kalon disa bashkive për mirëmbajtje është shumë ulët në raport me shumën që merr ARRSH-ja për të njëjtën kategori rruge dhe distancë prokurohet me 7-fish më shumë;
  - Menaxhimi i Mbetjeve Urbane disa bashki nuk përfitojnë kompensim për distancën ndërmjet bashkisë dhe landfillit e cila duhet të parashikohet në buxhet;

- Në grandin e kushtëzuar që vjen për investime të drejtpërdrejta ndryshimi i manualit të çmimeve që ndodhi vitin e kaluar nuk është pasqyruar në % këtu tek këto vlera, pra ajo që kemi humbur nga manuali nuk është përshtatur në këtë grand;
  - Pagesa e tarifave dhe taksave të bashkive për shoqëritë shtetërore që janë në faliment të bëhet nga ministria përgjegjëse. Duhet të vendoset një standard në buxhetin e shtetit që tarifat dhe taksat vendore të shoqërive tregtare të përcaktohet tek buxheti i Ministrive të Linjës;
  - Të përcaktohet nga Ministria e Mjedisit një buxhet për diferencën e kostos që bashkitë nuk e mbulojmë dot vet për funksionimin e inceneratorëve;
  - FSHZH-it të caktojë një fond të dedikuar për bashkitë i cili administrohet nga vetë bashkitë;
  - Të sqarohet në raportin e buxhetit se sa përqind të diferencës midis nevojave dhe të ardhurave të veta plotësohet me shtesën e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2025;
  - Të quartësohet sa është kostoja e rritjes së pagave për vitin 2025 dhe nga disa përllogaritje në koston e marrë përsipër nga Qeveria mungon një tremujor;
  - Të rishikohen fondet që kalojnë për funksionet e decentralizuara pasi nuk është bërë një llogaritje e saktë e kostos së këtij shërbimi që në momentin e kalimit të funksionit
6. Për projektligjin “**Për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit**”, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
  7. Për projektudhëzimin “**Për radhën e vendosjes së elementëve të adresës, algoritmin dhe strukturën e kodit unik të adresës dhe përdorimin e tij**”, propozuar nga Ministria e Brendshme, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
  8. Për projektvendimin “**Për disa ndryshime në Vendimin nr.1139, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026 dhe të planit të veprimit 2021-2023”**”, propozuar nga Ministria e Brendshme, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim

Z. Arbjan MAZNIKU

Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor  
Bashkëkryetar

Z. Aldrin DALIPI

Kryetar i Shoqatës së Këshillit  
të Qarqeve të Shqipërisë  
Bashkëkryetar